



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:118272
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05817452

C.nr.1472/20

2020:118273

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.E. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Jeton Berisha nga Ferizaj kundër të paditurit F., Gj., J. dhe A.Z., të gjithë nga Fsh. ... -K.Ferizaj, me objekt kontesti vërtetim pronësie, vlera e kontestit e pacaktuar, me datë 13.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **ndërpritet** për shkak të vdekjes së të paditurit F.Z. dhe A.Z..

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij av. Jeton Berisha nga Ferizaj pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 22.09.2020 kundër të paditurve, me objektin e kontestit vërtetim pronësie, vlera e kontestit e pacaktuar.

Gjykata sipas detyrës zyrtare iu është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile-Ofiqarisë në Ferizaj dhe Stacionit Policor në Ferizaj, me kërkesë për verifikim të adresës së të paditurve, pasi që gjatë tentimit të dorëzimit të aktvendimit për përgjigje në padi, padisë dhe provave që gjinden

në lënd sipas fletëdorëzimeve për pranim personal ka rezultuar që pala është i shpërngulur përkatësisht jeton jashtë vendit.

Stacioni Policor në Ferizaj, përmes Memorandumit Zyrtar të dt. 31.05.2024, nr. i ref. 04/.../24, e ka njoftuar gjykatën se lidhur me këtë është kontaktuar Gj.Z. dhe i njëjti njofton se adresa e sakt e tij është fsh. ., vëllau i tij F.Z. dhe motra e tij A.Z. kanë vdekur ndërsa J.Z. gjendet në Austri.

Andaj, bazuar në memorandumimin zyrtar të Policisë së Kosovës, konform dispozitave ligjore nga neni 277 pika a) të LPK-së, gjykata ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore. Ndërsa ka vendosur se procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-të paditurit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Nga arsyet e lartcekura e konform nenit 387, pika e) e LPK lidhur me nenin 142 të LPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1472/20, me datë 13.06.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e nëpërmjet kësaj gjykate.